# DËSHMI ARKIVI

**A-460981**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Skuadra e Besnik Hasit trondit Besiktasin dhe merr kreun e Superligës turke |
| ADRESA | `https://www.syri.net/sport/918064/skuadra-e-besnik-hasit-trondit-besiktasin-dhe-merr-kreun-e-superliges-turke/` |
| BURIMI | syri.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 20 shtator 2026, 20:12:37 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 20 shtator 2026, 20:06:33 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d3adf36fa294f79bc470a763510d7cd47354b13e19ec4bf04c8c9cd0fbb248e7` |
| TEKSTI | `761bd77a101951d2c8f90595e7cf640c503e03e9f625bd1ba7920ad915926ec5` |
| PAMJA | `ed576acd449bd7b1131ad5ccaad4fce8be327dea4dd3b8a4a9936883adea5c9c` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `52c09cc59b6651fa3d6ab2f5bde775911dee9c90d854421f36a3727d1ffdc930` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `d6a36024fef06cd2a7915f3a91ac1ec4390e61f25659ece2cd1751f77a3cac08` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/52c09cc59b6651fa3d6ab2f5bde775911dee9c90d854421f36a3727d1ffdc930`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



# Skuadra e Besnik Hasit trondit Besiktasin dhe merr kreun e Superligës turke

22:06, 20/09/2026

Amedspor ka marrë një fitore spektakolare 3-2 ndaj Besiktasit në Superligën e Turqisë, duke konfirmuar startin fantastik të sezonit.

Skuadra e drejtuar nga Besnik Hasi tashmë është ngjitur në krye të renditjes me 13 pikë pas gjashtë javësh.

Amedspor e nisi furishëm takimin dhe zhbllokoi rezultatin në minutën e 13-të me Gift Orban.

Vetëm në minutën e 22-të, Dia Saba dyfishoi avantazhin me një goditje të saktë brenda zonës.

Besiktasi reagoi pas pushimit dhe në minutën e 55-të Dusan Vlahovic shënoi për 2-1.

Por Amedspor nuk u tremb dhe vetëm katër minuta më vonë riktheu avantazhin e dyfishtë.

Furkan Soyalp përfitoi nga një gabim i mbrojtjes kundërshtare dhe realizoi për 3-1.

Në minutën e 84-t, Amedspor mbeti me dhjetë lojtarë pas kartonit të kuq për Amadou Cisse.

Besiktasi shtoi presionin dhe në minutën e 90+8-të Orkun Kokçu shënoi nga pika e bardhë për 3-2.

Megjithatë, Amedspor rezistoi deri në fund dhe siguroi tri pikë me peshë të madhe.

Në këtë sukses luajtën gjatë gjithë ndeshjes edhe shqiptarët Lumbardh Dellova dhe Ermal Krasniqi.

Ndërkohë, Milot Rashica u aktivizua në minutën e 71-të për Besiktasin.

Amedspor ka shënuar 15 gola në gjashtë javët e para, duke treguar forcë të madhe në fazën sulmuese.

Nën drejtimin e Besnik Hasit, skuadra nga Diyarbakiri po shijon një nisje mbresëlënëse dhe tashmë sheh nga kreu i Superligës turke.

© SYRI.net

më të lexuarat

Julian Alvarez rikuperohet në kohë, gati për derbin ndaj Real Madridit

'Dua Real Madridin në Champions'/ Intervista e Yamal: Si e bërtitura e Busquets më ndryshoi jetën

Laporta revoltohet për kalendarin: Kjo pauzë nuk ka aspak kuptim, lojtarët po paguajnë çmimin

VIDEO/ Fenerbache shpartallon 8-0 kundërshtarin, Vedat Muriqi shënon 4 gola

Granit Xhaka në mbështetje të çlirimtarëve: Luftuan në tokën e tyre për lirinë e atdheut!

Eric Garcia zgjedh favorit për 'Topin e Artë': E meriton Lamine Yamal

© SYRI.net

Lexo edhe:



VIDEO/ Pulisic ndez 'San Siron', Milani e mbyll pjesën e parë në avantazh ndaj Lecces




Kategoria Superiore/ Teuta dhe Dinamo City nuk njohin humbje prej 4 javësh, Egnatia rikthehet te fitorja



Superiore/ Egnatia fut Partizanin në krizë para derbit

Bëje LIKE dhe merr lajmin e fundit nga Sporti:

## Komentet

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto

VIDEO/ Atletico triumfon ndaj Realit në derbin e ndezur të Madridit

Zyrtare: Chelsea ndryshon pronësinë, Todd Boehly largohet nga klubi

Superiore/ Duel me gola dhe spektakël, Tirana dhe Elbasani ndajnë pikët në stadiumin e boshatisur

TË NGJASHME

VIDEO/ Juventusi rikthehet te fitorja, Zhegrova protagonist në suksesin ndaj Atalantës

Kategoria e Parë/ Mbyllet java e 4-t, fitojnë Kukësi, Burreli dhe Besëlidhja

'Çfarë turpi!'/ Shpërthejnë te Real Madridi ndaj gjyqtarit të derbit me Atleticon

Superiore/ Duel me gola dhe spektakël, Tirana dhe Elbasani ndajnë pikët në stadiumin e boshatisur

VIDEO/ Atletico triumfon ndaj Realit në derbin e ndezur të Madridit

VIDEO/ Fenerbache shpartallon 8-0 kundërshtarin, Vedat Muriqi shënon 4 gola

Laporta revoltohet për kalendarin: Kjo pauzë nuk ka aspak kuptim, lojtarët po paguajnë çmimin



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.